



REPUBLIKA E KOSOVËS/REPUBLIKA KOSOVA

DHOMA E DYTE E GJYKATES KOMERCIALE

Numri i lëndës: 2019:263053

Datë: 15.07.2024

Numri i dokumentit: 05938963

K.DH.SH.II.nr.1194/23

GJYKATA KOMERCIALE E KOSOVËS -Dhoma e Shkallës së Dytë, në kolegjin e përbërë nga gjyqtarët, Franciska Zhitija Ymeri kryetare e kolegjit, Saranda Bogaj Sheremeti dhe Dren Rogova, anëtar të kolegjit, në konfliktin administrativ sipas padisë së paditësit N.T.P “Niti Com” me seli në Istog, të cilin sipas autorizimit e përfaqëson I.A., kundër të paditurës Dogana e Kosovës në Prishtinë, me bazë juridike, anulim vendimi, duke vendosur lidhur me ankesën e paditësit, ushtruar kundër Aktgjykimit të Gjykatës Komerciale të Kosovës-Dhomat e Shkallës së Parë, Departamenti Fiskal, KF.nr.71/22 të datës 13.07.2023, në seancën e kolegjit të mbajtur me datë 11.07.2024, merr këtë:

A K T G J Y K I M

Refuzohet si e pa bazuar ankesa e paditësit N.T.P “Niti Com” me seli në Istog, e datës 18.08.2023, ndërsa aktgjykimi i Gjykatës Komerciale të Kosovës-Dhomat e Shkallës së Parë, Departamenti Fiskal, KF.nr.71/22 të datës 13.07.2023, vërtetohet.

A r s y e t i m i

Me aktgjykimin e Gjykatës Komerciale të Kosovës-Dhomat e Shkallës së Parë, Departamenti Fiskal, KF.nr.71/22 të datës 13.07.2023, nën pikën I të dispozitivit të aktgjykimit, ka refuzuar kërkesëpadia e paditësit N.T.P “Niti Com” me seli në Istog, të cilin sipas autorizimit e

përfaqëson I.A., si të pa bazuar. Nën pikën II. Mbetet në fuqi aktvendimi nr.07.3/1205/2015 i datës 01.08.2019 i Doganës së Kosovës në Prishtinë. Ndërsa nën pikën III. Secila palë i bart shpenzimet e veta procedurale.

Kundër këtij aktgjykimi në afatin ligjor ka ushtruar ankesë përfaqësuesi i autorizuar i paditësit për shkak të: vërtetimit të gabuar apo jo të plotë të gjendjes faktike. Me propozim që Dhoma e Shkallës së Dytë ta anuloj aktgjykimin KF.nr.71/23 dhe të mbetet në fuqi aktgjykimi A.nr.2021/19 i datës 20.09.2021 dhe vlera e kthimit nga Dogana e Kosovës të jetë e aplikuar në procedurë të kthimit për dy DUD-at e sipërhënuar në shumë prej 2,413.29€.

Përgjigje në ankesë nuk është paraqitur.

Gjykata Komerciale-Dhoma e Shkallës së Dytë, shqyrtoi shkresat e lëndës, aktgjykimin e ankimuar, pretendimet ankimore dhe pas vlerësimit të tyre në kuptim të nenit 49 të LKA-së, nenit 81.h të Ligjit për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit për Administratën Tatimore dhe Procedurat nr.03/L-222, lidhur me nenin 194 të Ligjit për Procedurën Kontestimore (LPK), të aplikueshëm sipas nenit 63 të Ligjit për Konfliktet Administrative (LKA), gjeti se:

Ankesa është e pa bazuar.

Nga shkresat e lëndës rezulton se me aktvendimin e kundërshtuar me nr.07.3/1205/2015 i datës 01.08.2019 të Doganës së Kosovës në Prishtinë, është refuzuar kërkesa e subjektit në procedurë N.T.P “Niti-Com”-Istog për rishqyrtimin e vendimeve R-20397/02.11.2015 dhe R-20410/02.11.2015 të ZBD Mitrovicë, si e pa bazuar.

Paditësi i pakënaqur me aktvendimin e lartë cekur të Doganës së Kosovës në Prishtinë, ka ushtruar padi për konflikt administrativ me datën 28.08.2019, me pretendim se i njëjti është i pa drejtë dhe i paligjshëm.

Dhoma e Shkallës së Parë-Departamenti Fiskal, pas shqyrtimit të padisë së paditësit paraqitur kundër aktvendimit nr.07.3/1205/2015 i datës 01.08.2019 të Doganës së Kosovës në Prishtinë, dhe pas administrimit të provave si në procesverbal të shqyrtimit kryesor e duke u bazuar edhe në provat dhe dëshmitë e tjera të lëndës, bie aktgjykimin e ankimuar me të cilin kërkesëpadinë e paditësit e refuzon si të pa bazuar, duke lënë në fuqi aktvendimin e lartcekur të Doganës së

Kosovës në Prishtinë. Me arsyetim se Gjykata konstaton se Dhomave të Shkallës së Dytë të kësaj gjykate, me aktvendimin K.DH.SH.II.nr.933/22 të datës 02.02.2023 të Dhomave të Shkallës së Dytë të kësaj gjykate, lëndën e kanë kthyer në rishqyrtim dhe rivendosje pranë kësaj gjykate me arsyetimin se duhet angazhuar ekspert financiar për të vërtetuar saktë gjendjen faktike. Për të vërtetuar konstatimet e cekura si në arsyetimin e vendimit kontestues dhe pretendimet e paditësit të paraqitura në padi dhe gjatë shqyrtimit gjyqësor, Gjykata sipas propozimit të autorizuarit të palës paditëse përmes aktvendimit KF.nr. 71/23 të datës 23.03.2023 ka caktuar ekspertizë financiare në këtë kontekst tregtar administrativ me ekspertin financiar I.S.. Ekspertja financiare në ekspertizën financiare të datës 10.05.2023, ka konstatuar se deklarata doganore e paditësit gjatë doganimit të mallit ka qenë jo e plotë, sepse ka deklaruar si vlerë malli vetëm çmimin blerës, por jo edhe shpenzimet e transportit dhe shpenzimet e ankandit. Dogana e Kosovës ka zbatuar gabimisht metodën e IV pasi ka bërë rivlerësim të mallit i cili ishte pajisur me dokumentacion përcjellës të mjaftueshëm dhe të kuartë. Anasjelltas vlera e mallit sipas kësaj metode ka rezultuar shumë më e lartë dhe jo reale. Si bazë doganore do të duhej të aplikohet çmimi i transaksionit prej gjithsejtë 6,560€ dhe TVSH-ja do të duhej të ishte prej 1,180.80€, në mbivlerësimin e mallit Dogana ka caktuar TVSH-në prej gjithsejtë 3,594.09€ i zbritet vlera reale e TVSH-së që do të duhej të paguhej, prej 1,180.80€, rezulton vlera e paguar më tepër prej 2,413.29€ (diferenca) e cila duhet ti kthehet palës paditëse, nëse gjykata e vlerëson kërkesëpadinë si të bazuar. Në seancën e shqyrtimit kryesor ekspertja financiare pas pyetjeve të gjykatës lidhur me detyrat sikurse në aktvendimin KF. Nr. 71/2023 të datës 23.03.2023, e njëjta deklaroi se: fatura (kontestuese) ka numër 2083663640002 dhe ka vlerë prej 2,400.00€ e cila faturë iu referohet 2 DUD-ave kontestues, tutje thekson se në shkresat e lëndës pagesë të veçantë që i referohet shumës prej 2,400.00€ për faturën si më lartë nuk kam hasur në shkresat e lëndës me përjashtim të pagesës së datës 09.10.2015 në shumë prej 3,367.20€, dhe në fund konstaton se nuk mendoj që është i harmonizuar në kuptim të vlerës transaksioni me faturë të mallit. Gjykata, pretendimin e paditësit se aktvendimi i kontestuar nuk e ka trajtuar drejtë gjendjen faktike, prandaj si i tillë kërkon që të anulohet, përveç të theksuar në padi si të tillë nuk e ka argumentuar me asnjë provë të vetme materiale këtë pretendim e sipas nenit 7, Paragrafi 1, dhe 3, i Ligjit për Procedurën Kontestimore nr. 03/L-006 parasheh se: “Palët kanë për detyrë të paraqesin të gjitha faktet mbi të cilat i mbështesin kërkesat e veta dhe të propozojnë prova me të cilat konstatohen faktet e tilla”. Nga provat e administruara në këtë konflikt administrativ gjykata nuk ka mundur të vërtetoj një gjendje tjetër faktike nga gjendja të cilën e ka konstatuar organi i paditur gjatë procedimit administrativ, për arsye se as në këtë kontest tregtar administrativ paditësi nuk ka qenë në gjendje që gjykatës t’ia dëshmoj provat për të

vërtetuar se vlera e mallit lëndor është vlerë e vërtet e transaksionit e paguar për mallrat e shitura për eksport në Kosovë, siç parashihet me dispozitat e nenit 33 të Kodit Doganor dhe të Akcizave nr. 03/L-109. Përkundrejt pretendimeve të paditësit në padi i cili thekson se mallin lëndor e kanë përcjell të gjitha dokumentet e nevojshme të cilat kërkohen për vendosje të mallit në qarkullim të lirë, gjykata konstaton se dokumentacioni për mallin lëndor i paraqitur në këtë konflikt administrativ është i pamjaftueshëm për të konstatuar se vërtet paditësi ka paraqit vlerën reale të mallit lëndor.

Qëndrimin juridik të Dhomës së Shkallës së Parë, si të rregullt dhe të bazuar në ligj në tërësi e pranon edhe Dhoma e Shkallës së Dytë, për arsye se aktgjykimi i ankimuar nuk është përfshirë me shkelje qenësore të dispozitave të Ligjit për Konfliktet Administrative, të cilat shkelje gjykata e shkallës së dytë i heton sipas detyrës zyrtare në bazë të nenit 194 të Ligjit për Procedurën Kontestimore, të aplikueshëm sipas nenit 63 të Ligjit për Konfliktet Administrative. Gjykata e shkallës së parë duke vlerësuar ligjshmërinë e aktvendimit të kontestuar mbështetur në dispozitat nga neni 8 i Ligjit për Procedurën Kontestimore (LPK-së), në drejtim të thënieve në padi, në përgjigje në padi, provave të administruara në seancë gjyqësore si dhe pas shqyrtimit të shkresave të tjera të lëndës me të drejtë ka konstatuar se kërkesëpadija e paditësit është e pa bazuar.

Sa i përket pretendimeve ankimore të paditësit, se ekspertja financiare ka punuar dhe ka dokumentuar se procedura e aplikuar nga Dogana e Kosovës për rivlerësim nuk ka qenë adekuate dhe nuk ka pas bazë ligjore përderisa dokumentacioni për mall ka qenë në dispozicion dhe vlera e përgjithshme e mallit është sipas transferit-pagesës së datës 09.10.2015 në vlerë prej 3,367.20€, tutje ka theksuar se me përgjegjësi të plotë penale dhe juridike deklarojmë dhe konfirmojmë se vlera e mallit të paguar është vlerë reale prej 2,400.00€ dhe atë përmes transferit të mësipërm, andaj në mënyrë të gabuar është anashkaluar dokumenti i pro faturës ku në këtë pro faturë ka qenë e përfshirë dhe e paguar edhe vlera e mallit në shumë prej 2,400.00€ përmes transferit me datë 09.10.2015 në vlerë prej 3,367.20€. Këto pretendime ankimore nuk qëndrojnë, ngase kolegji ka vlerësuar se Dhoma e Shkallës së parë me të drejtë nuk ia dha besimin e plotë ekspertizës financiare të datës 10.05.2023, ngase të njëjtën gjykata e vlerësoj si jo të drejtë për vërtetimin e fakteve vendimtare në këtë kontest tregtar administrativ, si dhe gjeti se nuk është në harmoni me legjislacionin doganor të aplikueshëm në Kosovë, por gjykata vlerësoi sqarimet e ekspertës të dhëna në seancë dhe të njëjtën e morri si të drejtë dhe të sakta ngase përgjigjet e dhëna janë në harmoni me shkresat e lëndës dhe bazën ligjore doganore.

Kolegji konsideron se Dhoma e Shkallës së Parë me rastin e shqyrtimit të padisë së paditësit, ka nxjerrë prova të mjaftueshme të cilat vërtetojnë se pretendimet e paditësit janë të pa bazuara, ngase nga provat e administruara, gjykata nuk ka mundur që të vërtetoj një gjendje tjetër faktike nga gjendja të cilën e ka konstatuar organi i paditur gjatë procedimit administrativ, për arsye se as në konflikt administrativ dhe as me pretendimet ankimore të theksuara në ankesë paditësi nuk ka qenë në gjendje që gjykatës t'ia dëshmojë provat për të vërtetuar se vlera e mallit lëndor është vlerë e vërtetë e transaksionit e paguar për mallrat, siç parashihet me dispozitat e nenit 33 të KDAK-së. Dhoma e Shkallës së Parë drejtë ka konstatuar gjendjen faktike kur ka theksuar se transaksioni bankar ndërkombëtar i datës 09.10.2015, në kuptim të shumës përputhet me shumën sikurse në pro faturën nr. 1652545 të datës 30.09.2015, dhe e cila në përshkrim të saj përfshinë 4 pozicione të pagesave të ndryshme deri në shumën totale prej 3,367.20€, por që në asnjë nga këto pozicione nuk është e përfshirë edhe shuma prej 2,400.00€ siç është theksuar në faturë, apo përshkrimi që i referohet mallit sikurse në faturën kontestuese. Prandaj, Dhoma e Shkallës së Parë drejtë ka vendosur kur i ka pranuar konstatimet e cekura në arsyetimin e vendimit kontestues se nuk mund të vepohet sipas pretendimeve të paditësit që malli të vlerësohet sipas dokumentacionit të prezantuar pasi që paditësi nuk ka paraqitur dokumentacion të besueshëm dhe të kompletuar për të dëshmuar se çmimi i deklaruar është çmim real i paguar për mallin lëndor kontestues.

Dhoma e Shkallës së Dytë duke u nisur nga gjendja e tillë e çështjes gjen se Dhoma e Shkallës së Parë nuk ka gjetur fakte të bazuara që argumentojnë me prova konkrete, pagesën për blerjen e mallit lëndor. Sepse, paditësi nuk ka prezantuar dokumentacion të kompletuar dhe të harmonizuar për të dëshmuar se çmimi i deklaruar është çmim real i paguar për mallin lëndor kontestues. Kolegji vlerëson se e paditura ka vepruar drejtë kur me vendimin kontestues ka konfirmuar rivlerësimin e mallit lëndor në bazë të metodës së 6 të vlerësimit në pajtim me nenin 35 i Kodit Doganor dhe të Akcizave të Kosovës, përkatësisht në bazë të dhënave të disponueshme lidhur me vlerën e mallit. Andaj, duke u nisur nga gjendja e tillë e çështjes, kolegji i kësaj gjykate gjen se Dhoma e Shkallës së Parë drejtë ka vendosur kur është bazuar në dispozitat ligjore të nenit 43 paragrafi 1 dhe 46 paragrafi 2 të Ligjit për Konfliktet Administrative.

Nga tërë kjo që u cekë më lartë dhe mbi këtë gjendje faktike, kolegji konsideron se gjendja faktike është vërtetuar drejtë dhe në mënyrë të plotë, ngase nuk është cenuar ligji në dëm të paditësit, sepse, aktgjykimi i ankimuar i Dhomës së Shkallës së Parë, është i qartë dhe i

kuptueshëm si dhe përmban arsye të mjaftueshme për faktet vendimtare, të cilat i pranon edhe Dhoma e Shkallës së Dytë, andaj, ankesa e paditësit u refuzua si e pa bazuar, ndërsa aktgjykimi i ankimuar u vërtetua si i drejtë dhe i ligjshëm. Duke marrë parasysh se Dhoma e Shkallës së Parë, në mënyrë të drejtë ka zbatuar dispozitat procedurale dhe materiale, me rastin e refuzimit të kërkesëpadisë së paditësit, e pasi që me pretendimet tjera ankimore të përsëritura, të njëpasnjëshme, një aktgjykim i tillë nuk mund të vihet në pyetje, ankesa e të paditësit u refuzua si e pa bazuar, ndërsa aktgjykimi i ankimuar u vërtetua si i drejtë dhe i ligjshëm.

Mbi këtë bazë e në mbështetje të nenit 49 të LKA-së, lidhur me nenin 200 të LPK-së, të aplikueshëm sipas nenit 63 të LKA-së, u vendos si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

GJYKATA KOMERCIALE E KOSOVËS-Dhoma e Shkallës së Dytë

K.DH.SH.II.nr.1194/23, me datë 11.07.2024

Kryetare e kolegjit,
Franciska Zhitija Ymeri